



Java Kundër
KORRUPSIONIT
3-9 DHJETOR 2017

FARMACEUTIKA PA ILAÇ



#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

INPO
INSTITUTI I NJËZEMTËSIAVE

SHËRBËTËSI I GAPIT



QENDRA PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE



Autor: Instituti Columbus

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.



Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.



Ky projekt është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të Institutit Columbus dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Rreth Institutit Columbus

Instituti është themeluar si organizatë e pavarur, joqeveritare, joprofitabile me vullnet të mirë dhe ka si qëllim promovimin e filozofisë politike dhe shoqërore të lirisë, demokracisë dhe barazisë në Kosovë.

Adresa: Nena Terezë 31b; Tel: +381 (0) 38 243 875 ; +377 (0) 44 555 404;

E-mail: info@instituticolumbus-ks.com

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	3
II.	Përshkrim i rastit	4
III.	Gjetjet konkrete	5
IV.	Pyetjet publike	5

I. Përmbledhje ekzekutive

Rreth 21 milionë euro në vit ndahen për buxhetin e nevojshëm për barna dhe material shpenzues në Kosovë. Por, për zyrtarët shëndetësorë, ky buxhet vazhdimisht është cilësuar si i pamjaftueshëm për të përmbushur listën esenciale dhe nevojat e pacientëve. Nga Qendra Klinike Universitare adresohen kritika në adresë të Ministrisë së Shëndetësisë, për blerjen e barnave me çmime më të larta sesa çmimi real në treg. Ministria e Shëndetësisë, përveçse ballafaqohet me një mungesë dhe kufizim të madh të fondeve për të siguruar shërbime të duhura dhe cilësore për qytetarë, vet buxheti aktual i saj nuk është duke u menaxhuar në mënyrën e duhur. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se buxheti nuk është shpenzuar me efikasitet, gjë që do t'u mundësonte qytetarëve që të marrin shërbime sa më cilësore me këtë nivel të fondeve që ka në dispozicion kjo ministri. Është e qartë se mungesa e fondeve e ka kufizuar nivelin e shërbimeve, por menaxhimi jo i mirë në këtë sektor, në shumicën e tenderëve të analizuar, është gjithashtu një problem i cili duhet të ketë adresim urgjent dhe të duhur nga ana e këtij institucioni. Institucionet publike shëndetësore, prej pas luftës, nuk kanë arritur ta përmbushin listën esenciale me barna, për shkak të buxhetit të ulët që ka Ministria e Shëndetësisë, dedikuar furnizimit me barna. Por, pavarësisht kësaj, shpeshherë ndodh që manipulimet me barna, si blerja e tyre me çmim shumëfish më të shtrenjtë se vlera reale, të mos mungojnë.

Sot, furnizimi farmaceutik publik është shumë i centralizuar; prokurimi i barnave dhe materialit mjekësor bëhet nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) – Departamenti i Prokurimit. Furnizimi i institucioneve shëndetësore (spitaleve, qendrave kryesore të mjekësisë familjare) me barna është i organizuar nga magazina qendrore. Furnizimi me barna dhe material mjekësor është i bazuar në Listën e Barnave Esenciale (LE) të aprovuar nga MSh-ja dhe procedurat e distribuimit janë të bazuara në baza mujore ose tremujore. Në veçanti, dy vjetët e fundit, Ministria e Shëndetësisë ka humbur miliona euro për shkak të blerjeve shumë të shtrenjta të produkteve të listës esenciale të barnave. Kjo ministri ka përzgjedhur fituesit e tenderëve me çmime shumëfish më të shtrenjta sesa çmimi real i tyre. Një gjë e tillë cilësohet si e jashtëligjshme me Ligjin e Prokurimit Publik, që e rregullon këtë çështje. Nëse krahasohen çmimet e fituesve të tenderit për këto produkte del që janë shumëfish më të shtrenjta edhe sesa produktet në tregun privat – barnatore, por edhe shumëfish më të shtrenjta se të njëjtat produkte që janë blerë nga MSH-ja vitet e kaluara.

II. Përshkrim i rastit

Monitorimi i prokurimit publik në MSH është i dobët, pasi që aktualisht Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nuk po kryen rolin e vet në mbikëqyrjen e kësaj ministrie. Arsyet mund të jenë të ndryshme dhe shpeshherë objektive, mirëpo krejt kjo e bën sistemin e prokurimit publik në këtë sektor të brishtë dhe të rrezikuar në vazhdimësi ndaj dukurive korruptive dhe sidomos keqmenaxhimit sistematik. Megjithëse kjo ministri vazhdon të përfillet për keqmenaxhim të proceseve tenderuese, mbikëqyrja e prokurimit publik nga ana e institucioneve përgjegjëse vazhdon të mbetet e ulët. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me nenin 88.1, ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësi për të vëzhguar, monitoruar dhe mbikëqyrur aktivitetet e prokurimit në të gjitha autoritetet kontraktuese të Kosovës. Një gjë të tillë nuk po e bën në rastin e blerjeve shumë të shtrenjta të barnave. Sipas hulumtimit të medieve, ky institucion po i blen barnat nëntë herë më shtrenjtë sesa çmimi real.¹

Abuzimet e planifikuara nga firma farmaceutike në bashkëpunim me institucionet shtetërore sollën krizën e barnave në disa spitale të vendit.

Ministria e Shëndetësisë e ka të vështirë të parandalojë blerjen e barnave me çmime shumëfish me të shtrenjta sesa çmimi real i tyre në tregun privat. Baza ligjore nuk është në favor të përpjekjes së kësaj ministrie për anulimin e tetë tenderëve dhe këtë vlerësim pritet ta japë edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). Vendimet e OSHP-së kanë rezultuar në favor të kompanive fituese. Përzgjedhja e fituesve nga Ministria e Shëndetësisë është bërë me nxitim dhe pa konsultimin e çmimeve referente në treg, ashtu siç i obligon ligji. Ndërsa nga institucionet që kanë për qëllim të evitojnë shkeljet dhe korrupsionin në këtë sektor, rreziku shfaqet në humbjen e besimit të këto institucione, sidomos të institucioni i vetëm për ankesa – OSHP.

Sikur autoriteti kontraktues, të përdorte kriterin ekonomikisht më të favorshëm, potencialisht do të rriste edhe gjasat për shpenzim më racional të parasë publike.

Përpos këtyre, blerjet e barnave në vazhdimësi janë shoqëruar me parregullsi dhe shkelje të tjera, ku ndër to janë edhe mosfrimi i kushteve adekuate për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e barnave në depot e operatorëve ekonomikë, të cilët furnizojnë MSH-në. E gjithë kjo tregon se bizneset kosovare që shesin produkte medicinalenuk inspektohen si duhet nga MSH-ja. Dëmi financiar nga diferenca mes çmimeve është shumë i madh.

Kontratat e lidhura nga Ministria e Shëndetësisë, që i blejnë barnat për QKUK-në, i kanë më të shtrenjta 3 milionë euro për gjashtë muaj furnizim, sesa të njëjtat kur janë blerë nga QKUK-ja vite më parë. Ta zëmë, një ilaç ‘fermibarbiton’, që në treg kushton 1.5 euro, Ministria e Shëndetësisë e blen 9 euro.

¹<http://www.koha.net/arberi/25755/ministria-e-shendetesise-ne-kosove-blen-barnat-me-shtrenjte-sesa-cmimi-ne-treg/>

III. Gjetjet konkrete

- MSH-ja po keqpërdor buxhetin duke paguar barnat shumëfish me shtrenjtë sesa çmimi real. Ky institucion nuk ka kriter të çmimit. Duke mos caktuar një kufi për paratë sa do të paguajë, po ua lë në dorë operatorëve ekonomik të paguajnë sa të duan për këto produkte
- Nuk zhvillohet dhe implementohet politika e çmimeve të barnave, posaçërisht duke marrë parasysh oportunitetin unik të procesit në vijim të autorizimit për marketing. Çmimi dhe kualiteti i barnave (bashkë me karakteristikat epidemiologjike të sëmundjeve që trajtohen) duhet të jenë kriteret kryesore për regjistrim të barnave në Agjencinë Kosovare të Produkteve Mjekësore – AKPM
- Mungesa e një liste referente të çmimeve të barnave, e cila do të kufizonte vlerën monetare të barnave
- Konsumatori nuk ka rol në vendimmarrje për produktet konkurrencte dhe përcaktimin e çmimit të tyre. Nga ana e ofertës, konkurrenca është e kufizuar për shkak të shkallës së lartë të fuqisë së tregut nga mbajtësit e patentave. Për këto arsye, është e kuptueshme që tregu farmaceutik nuk mund të funksionojë në kushtet e konkurrencës dhe duke shtuar faktin që shumë qeveri e konsiderojnë shëndetin një të mirë publike të domosdoshme (mbizotëron koncepti që pavarësisht nga mundësitë financiare, pacienti duhet ta ketë shërbimin farmaceutik), ky treg është i rregulluar në mënyrë joracionale. Por pavarësisht rregullimit, tashmë është e pranuar gjerësisht se konkurrenca mund dhe duhet të luajë një rol kryesor në mirëfunksionimin e tregut për më shumë përfitime për pacientët, më shumë zgjedhje, produkte më inovative dhe çmime më të ulëta
- kufizimet në furnizimin farmaceutik mbeten një pengesë kryesore për arritjen e një uljeje të ndjeshme të çmimit të barnave duke sjellë një furnizim të pabarabartë të popullatës dhe mungesë barnash në spitale, implementim me faza i kuadrit rregullator, i cili trajton si çështjet e kërkesës edhe ato të ofertës, që të mund të fillojnë të përmirësohen mangësitë aktuale.

IV. Pyetjet publike

- Sa kanë ndryshuar çmimi i produkteve të njëjta ndër vite?
- Sa është vlera në para?
- Cili është legjislacioni që lejon monopolin e disa kompanive të barnave në sektorin publik?
- Planifikimin e institucioneve (si është kurba e planifikimit të produkteve të njëjta, për numrin e pacientëve përfaqësuar të njëjtë, a ka ndikim në planifikim kompania që e fiton tenderin, pse institucioni rritë kërkesat për një produkt kur fiton një kompani e caktuar ndërsa ulë planifikim kur ndërrohet kompania furnizuese?)
- Sa shtrenjtë ose lirë blen Kosova barnat e Listës Esenciale në krahasim me shtetet e rajonit?